

URDHËR
Nr. 256, datë 24.3.2026

**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCËS SË MINISTRIT PËR EVROPËN DHE
PUNËT E JASHTME MBI ÇËSHTJET KONSULLORE**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në nenet 22 e vijuese të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; në ligjin nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të RSH-së”; në ligjin nr. 8372 datë 9.7.1998, “Për ushtrimin e funksioneve konsullore nga përfaqësitë diplomatike ose konsullore”; në ligjin nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe drejtorit të Drejtorisë së Çështjeve Konsullore, sipas përcaktimeve të këtij urdhri.

2. Drejtori i Drejtorisë së Çështjeve Konsullore është personi përgjegjës për nënshkrimin e akteve vijuese:

a) Përcjellje e akteve të gjendjes civile, lejeve të drejtimit, pasaportave sendeve të humbura, specimene të dokumenteve shqiptare apo të huaja;

b) Verifikim dokumentacioni (të lëshuara nga institucionet shqiptare):

- për identitetin e shtetasit shqiptarë;

- për figurën e kandidatit për konsuj nderi të RSH-së dhe të huaj;

c) Kërkesat për çelje-mbyllje aksesesh për diplomatët, operatorë tek Identitekt, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë;

d) Shkresa shoqëruese për postën diplomatike që përmban pasaporta dhe materiale të Identitekut.

e) Përcjellje praktikash për heqjen dhe rifitimin e shtetësisë shqiptare;

f) Përcjellje kërkesash për ekstradim, ndihmë juridike, ndalim, arrestim për shtetas shqiptar e të huaj.

3. Sekretarit të Përgjithshëm i delegohet kompetenca për nënshkrimin e të gjitha akteve të tjera me karakter konsullor, që nuk përfshihen në pikën 2 të këtij urdhri.

4. Njoftimet dhe komunikimet elektronike, për çështjet konsullore, i drejtohen drejtorit të Drejtorisë së Çështjeve Konsullore, duke vënë në dijeni Sekretarin e Përgjithshëm.

5. Të gjitha njoftimet/publikimet e aktiviteteve/njoftimeve konsullore në faqet, apo llogaritë zyrtare të rrjeteve sociale të MEPJ-së, si dhe të misioneve diplomatike/posteve konsullore të RSH-së, bëhen me miratimin e Sekretarit të Përgjithshëm, me propozim të Drejtorisë së Çështjeve Konsullore, në bashkëpunim me kabinetin e ministrit.

6. Titullarët e misioneve diplomatike dhe posteve konsullore të Republikës së Shqipërisë i raportojnë për veprimtarinë konsullore, në bazë ditore, drejtorit të drejtorisë që mbulon çështjet konsullore.

7. Drejtori i drejtorisë, që mbulon çështjet konsullore, i raporton në bazë ditore veprimtarinë konsullore, të ushtruar nga përfaqësitë/postet konsullore, Sekretarit të Përgjithshëm.

8. Ngarkohen me zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, drejtori i Drejtorisë së Çështjeve Konsullore, titullarët dhe punonjësit konsullorë në misionet diplomatike dhe postet konsullore të RSH-së, si dhe Drejtoria e Sekretarisë dhe Komunikimit Qendror.

9. Ky urdhër u njoftohet strukturave të ngarkuara dhe misioneve diplomatike e konsullore, Sektori i Menaxhimit të Dokumentacionit në Drejtorinë e Sekretarisë dhe Komunikimit Qendror.

10. Urdhri nr. 1090, datë 3.11.2025, “Për delegimin e kompetencës së ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme mbi Çështjet Konsullore”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

Ferit Hoxha